

RELACION

PËR PROJEKTLIGJIN

“PËR KONCESIONET DHE PARTNERITETIN PUBLIK-PRIVAT”

I. QËLLIMI I PROJEKT AKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji synon krijimin e një kuadri të qartë, të qëndrueshëm dhe konkurrues për nxitjen e investimeve private nëpërmjet koncesioneve dhe partneriteteve publike-private (PPP).

Projektligji përcakton rregullat për planifikimin, dhënien, administrimin dhe mbikëqyrjen e kontratave të koncesionit/partneritetit publik-privat, duke u mbështetur në parimet e transparencës, mosdiskriminimit, proporcionalitetit, efikasitetit dhe sigurisë juridike.

Projektligji synon:

- a) krijimin e një kornize të unifikuar për procedurat konkurruese;
- b) ruajtjen e interesit publik nëpërmjet kontrollit ex-ante dhe ex-post të ministrisë përgjegjëse për financat;
- c) siguron rregulla transparente për dhënien, zbatimin dhe monitorimin e kontratave të koncesionit dhe PPP;
- d) vendos mekanizma për ndarjen dhe menaxhimin e risqeve;
- e) harmonizon procedurat me standardet e BE-së për dhënien e kontratave të koncesionit;
- f) forcon rolin mbikëqyrës të ministrisë përgjegjëse për financat, Agjencisë së Prokurimit Publik (APP) dhe Agjencisë së Trajtimit të Koncesioneve (ATRAKO);
- g) promovon vlerën më të mirë për paranë (value for money) dhe mbrojtjen e interesit publik.

II. VLERËSIMI I PROJEKT AKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTAVE TË TJERA POLITIKE

Projektligji mbështet prioritetet e Qeverisë për rritjen ekonomike përmes mobilizimit të kapitalit privat në infrastrukturë, energji, mjedis, turizëm, shëndetësi e arsim. Ai është i planifikuar në Planin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve për vitin 2025, Programin Kombëtar për Integrimin Evropian dhe në strategjinë e menaxhimit të financave publike, duke kontribuar në objektivat e konsolidimit fiskal dhe përmirësimit të klimës së biznesit.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKT AKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Fusha	Përparësitë kryesore	Problematikat aktuale që adresohen	Efektet e pritshme
Transparenca & konkurrenca	Procedura të hapura/të kufizuara/me negocim, publikime elektronike, ftesa për shprehje interesi	Procedura më pak të përshtatshme, publikime të pjesshme	Rritje e pjesëmarrjes së operatorëve, ulje e kostove
Menaxhimi fiskal	Miratim paraprak i MF për çdo projekt, raporte tremujore monitorimi, regjistër elektronik PPP	Detyrime kontingjente të paidentifikuara, mungesë raportimi	Kufizim i rreziqeve buxhetore, shtim i transparencës fiskale
Përputhshmëria me BE	Përafrim me Direktivat 2014/23/BE, 2014/24/BE & 2014/25/BE	Mospërputhje terminologjike, paqartësi procedurash	Lehtësim i integritetit dhe i aksesit të investitorëve të BE-së
Antikorrupsioni	Detyrim për deklarim konflikti interesi; përjashtime për subjekte të dënuara	Raste të konfliktit jo të menaxhuara	Rritje e integritetit institucional

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUESHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI

Projektligji mbështetet në nenet 78 dhe 83, pika 1 të Kushtetutës Termat, procedurat dhe parimet janë përafruar me Direktivën 2014/23/BE (koncesionet) dhe me Direktivën 2014/24/BE (prokurimi klasik) për çështjet që kanë të bëjnë me procedurën konkurruese, komunikimet e njoftimeve, afateve dhe periudhës së pritjes.

V. SHKALLA E PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE

Ky projektakt synon përafrim të plotë me Direktivën 2014/23/BE (koncesionet), si dhe me dispozitat e prokurimit publik në direktivat përkatëse (2014/24/BE, 2014/25/BE).

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Kreu I - “Dispozita të përgjithshme” - i projektligjit “Për koncesionet dhe partneritetin publik-privat” formon bazën konceptuale të kuadrit të ri për koncesionet/PPP-të në Shqipëri. Ai përcakton se ligji synon të krijojë një mjedis të qëndrueshëm dhe transparent, që nxit investimet private në

infrastrukturë e shërbime publike përmes bashkëpunimit afatgjatë mes sektorit publik dhe atij privat. Neni i përkufizimeve liston termet themelore - si “koncesion”, “partneritet publik-privat”, “kontratë e përzier” apo “e drejta për shfrytëzim” -. Kreu parashikon edhe kufijtë e fushës së zbatimit, duke përfshirë, p.sh., licencat e zakonshme administrative dhe kontratat e caktuara kërkim-zhvillim. Parimet udhëheqëse—transparenca, trajtimi i barabartë, mosdiskriminimi, proporcionaliteti e siguria juridike—janë të detyrueshme që prej fazës së përgatitjes së projekteve. Ligji gjithashtu ndan rolet institucionale. Në krye qëndrojnë dy ministri linje:

- i. Ministria përgjegjëse për ekonominë orienton-koordinon politikat e përgjithshme për PPP-të, duke ushtruar rolin strategjik të shtetit në këtë fushë.
- ii. Ministria përgjegjëse për financat vepron si “rojtari fiskal”. Ajo miraton paraprakisht çdo studim fizibiliteti e projekt-kontratë, rivlerëson transferimet/ndryshimet kontraktore, kërkon raporte tremujore monitorimi dhe përgatit raportin vjetor të portofolit PPP, si aneks i raportit të zbatimit të buxhetit

Në nivel operativ veprojnë dy agjenci të specializuara:

- i. Agjencia e Prokurimit Publik (APP) publikon dokumentet standarde të tenderit dhe zbaton sanksionet e përjashtimit ndaj operatorëve që nuk plotësojnë kriteret e ligjit.
- ii. Agjencia e Trajtit të Koncesioneve (ATRAKO), në varësi të Ministrisë përgjegjëse për ekonominë, mbështet autoritetet kontraktuese në hartimin e studimeve të fizibilitetit, draft-dokumenteve të procedurës, vlerësimin e ofertave, negocimin, nënshkrimin dhe më pas monitorimin e kontratave. Ajo harton edhe dokumentacionin standard, propozon ndryshime ligjore dhe shërben si sekretariat teknik i organeve kolegjiale.

Për të vendosur prioritetet dhe për të përcaktuar projektet që meritojnë ekspertizë të specializuar, ekziston Komiteti i Përzgjedhjes së Projekteve PPP. Ai kryesohet nga Ministri i Ekonomisë dhe mbledh rreth tryezës ministrat e Financave, Infrastrukturës, Energjisë, Zhvillimit Urban e Mjedisit, duke siguruar filtrin ndër-sektorial para nisjes së projekteve strategjike. Sekretariati mbështetet me burime nga ATRAKO.

Autoritetet/entet kontraktuese – ministri, bashki, ose ente publike që plotësojnë kushtet e ligjit – mbajnë përgjegjësinë e drejtpërdrejtë për çdo procedurë dhe sigurojnë trajtim të barabartë të operatorëve ekonomikë. Teksti u kërkon të caktojë komisione teknike ad hoc dhe të shmangin çdo konflikt interesi gjatë procesit.

Struktura plotësohet nga Komisioni i Prokurimit Publik (KPP) – organ i pavarur i rishikimit administrativ që shqyrton ankesat kundër vendimeve të autoriteteve dhe, sipas rastit, pezullon ose anulon procedurën përpara nënshkrimit të kontratës.

Nëpërmjet ndarjes së qartë të roleve – strategji (Ekonomia), kontroll fiskal (Financat), rregullim (APP), asistencë teknike (ATRAKO), filtër ndër-ministrior (Komiteti) dhe zbatim/ankim

(Autoritetet + KPP) – ligji siguron një zinxhir përgjegjësie të plotë dhe mekanizma mbikëqyrjeje që mbrojnë interesin publik gjatë gjithë ciklit të PPP-ve.

Kështu, Kreu I vendos themelin parimor, terminologjik dhe institucional mbi të cilin ngrihen dispozitat e tjera të projektligjit.

Kreu II - “Veprimet paraprake” - përshkruan gjithë ciklin përgatitor që autoritetet duhet të përmbyllin para se të shpallin procedurën konkurruese për një koncesion/PPP.

Fillon me Nenin 18, i cili përkufizon “veprimet” si çdo aktivitet nga identifikimi i projektit deri te nënshkrimi i kontratës. Autoritetet lejohen të angazhojnë këshilltarë të jashtëm dhe, kur u duhet ekspertizë e specializuar, t’i drejtohen ATRAKO-s me kërkesë të argumentuar; kushtet teknike për këtë mbështetje do t’i rregullojë Këshilli i Ministrave.

Neni 19 parashikon procesin e identifikimit të projekteve: çdo autoritet kontraktues shqyrton mundësitë brenda fushës së tij, por mund të marrë nisma edhe nga Kryeministria, organe të tjera shtetërore, institucione financiare ose akademike. Gjithashtu parashikohet se autoritetet që kanë mungesë ekspertize mund ta sigurojnë ata nga ekspertë të jashtëm.

Për të administruar procesin e përgatitjes dhe atë të dhënies së koncesionet/PPP-së, neni 20 parashikon krijimin e një Komisioni të Koncesionit/PPP në nivel autoriteti/enti kontraktues, me numër tek anëtarësh (jo më pak se pesë). Sipas rastit, komisioni harton ose plotëson studimin e fizibilitetit, zgjedh procedurën, përgatit dokumentet e tenderit, vlerëson ofertat dhe propozon fituesin ose anulimin e procedurës; çdo hap dokumentohet.

Boshti analitik i kreut është Neni 21 mbi studimin e fizibilitetit. Ky dokument duhet të përfshijë:

- i. përshkrimin e projektit dhe investimet e planifikuara;
- ii. analiza teknike, financiare, ligjore, ekonomike e mjedisore;
- iii. vlerësimin e risqeve fiskale dhe ndikimit në buxhetin qendror/vendor;
- iv. treguesit e “vlerës së parasë”, harmonizimin me strategjitë kombëtare dhe interesin e tregut.

Para shpalljes së tenderit, studimi (dhe projekt-kontrata) i dërgohet Ministrisë përgjegjëse për financat për miratim paraprak; për projekte që kanë kaluar tashmë filtrin e menaxhimit të investimeve publike, kërkohet vetëm dorëzimi i projekt-kontratës.

Më tej, Neni 22 vendos një kufi monetar minimal, i cili miratohet me VKM dhe shërben si prag për aplikimin e ligjit, ndërsa Neni 23 detajon metodën e llogaritjes së vlerës—xhiro totale e koncesionarit gjatë gjithë kontratës, pa TVSH, për punët, shërbimet e mallrat e lidhura.

Në thelb, Kreu II siguron që çdo projekt PPP të kalojë një filtrim teknik, financiar dhe institucional (identifikim, komision, fizibilitet, miratim fiskal) dhe të respektojë parametrat e vlerës e të pragut monetar, përpara se të nisë faza konkurruese e Kreut III.

Kreu III – “Procedura për dhënien e koncesioneve/PPP” vendos rregullat që autoritetet duhet të ndjekin nga miratimi i urdhrit të nisjes deri në shpalljen e fituesit - duke siguruar transparencë, konkurrencë të ndershme dhe mbrojtje të interesit publik.

Pas miratimit të studimit të fizibilitetit nga ministria përgjegjëse për financat, procedura hapet me urdhrin e autoritetit kontraktor dhe mbyllet vetëm kur publikohet rezultati ose anulimi. Komunikimet me operatorët ekonomikë lejohen elektronikisht, me postë/faks apo procesverbal të protokolluar; pajisjet dhe format elektronike duhet të jenë të aksesueshme për të gjithë pjesëmarrësit. Për llojin e objektit përdoret detyrimisht nomenklatura CPV.

Procesi nis publikisht me njoftimin e kontratës, i cili jep të dhënat kryesore (objekti, vlera e parashikuar, afatet, organi i ankimit, etj.) dhe siguron akses në dokumentet e tenderit. Në procedurat me dy faza, kandidatët e parakualifikuar ftohen me një ftesë për ofertë ku përfshihet i gjithë informacioni teknik dhe kohor.

Specifikimet teknike e funksionale duhet të jenë të lidhura me objektin dhe pa referenca diskriminuese; oferta mund të pranohet edhe mbi bazë “ose ekuivalent”. Garancitë procedurale kërkojnë që çdo ofertë të plotësojë minimumet teknike, kriteret e kualifikimit dhe të mos bie në kushtet e përjashtimit. Vetë kushtet e kualifikimit janë të kufizuara në ato që lidhen drejtpërdrejt me aftësinë teknike, profesionale e financiare dhe mund të plotësohen edhe përmes kapaciteteve të palëve të treta.

Afatet minimale varen nga faza e procedurës: 30 ditë për kërkesat e pjesëmarrjes, 35 ditë për ofertat në një procedurë të hapur dhe mund të shkurtohen me përdorimin e mjeteve elektronike. Dorëzimi e hapja e ofertave kryhen në adresat e përcaktuara, dokumentohen me procesverbal dhe shoqërohen me deklarata kundër konfliktit të interesit.

Vlerësimi nuk mund të zgjasë më shumë se 30 ditë; komisioni përdor ofertën ekonomikisht më të favorshme si kriter themelor, të kombinuar me faktorë cilësie, mjedisi, tarifë koncesionare, etj., të peshuar paraprakisht në dokumente. Gjatë shqyrtimit lejohet vetëm korrigjimi aritmetik dhe sqarime që nuk ndryshojnë përmbajtjen e ofertës.

Rezultati publikohet si njoftim paraprak fituesi, duke hapur periudhën “stand-still” për ankesa. Autoriteti informon çdo kandidat për arsyet e refuzimit ose avantazhet e ofertës fituese brenda 10-15 ditësh nga kërkesa.

Procedura mund të anulohet vetëm në raste të mirëpërcaktuara, rrethana të paparashikueshme, gabime serioze në dokumente ose mungesë ofertash të përshtatshme; vendimi i arsyetuar njoftohet brenda pesë ditësh dhe u jep të drejtë operatorëve të ankimojnë.

Neni 48 – Propozimet e pakërkuara, vendos rregullat që lejojnë sektorin privat të nxisë vetë projekte koncesioni, pa çënuar konkurrencën dhe mbrojtjen e interesit publik.

Autoritetet kontraktuese mund të shqyrtojnë propozime të pakërkuara vetëm për punë/shërbime në porte, aeroporte, energjinë për ngrohje e shpërndarjen e gazit natyror, si dhe prodhimin-shpërndarjen e energjisë elektrike (përfshijë burimet hidrike). Këto propozime nuk pranohen nëse për projektin ka nisur ose është shpallur një procedurë përzgjedhjeje.

Autoriteti bën një verifikim të menjëhershëm të përmbajtjes dhe leverdishmërisë; propozimet “me studim minimal” refuzohen si të paplota. Nëse propozimi vlerësohet i pranueshëm, autoriteti nis procedurën konkurruese të rregullt për dhënien e koncesionit/PPP, duke publikuar dokumentet e tenderit dhe duke garantuar trajtim të barabartë për të gjithë operatorët.

Kur procedura përfundon me nënshkrimin e kontratës, propozuesi fillestar rimbursohet për shpenzimet e studimit të fizibilitetit vetëm nëse nuk shpallet fitues. Shuma e kompensimit kufizohet në 1 % të vlerës së investimit dhe paguhet nga ofertuesi fitues përpara nënshkrimit të kontratës; kjo vlerë dhe mënyra e pagesës publikohen në dokumentet konkurruese.

Ky nen synon të krijojë një balancë të përshtatshme mes lejimit të inovacionit dhe sipërmarrjes së iniciativës private dhe transparencës e interesit publik: e kufizon fushën e propozimeve të pakërkuara në sektorë strategjikë, bën që ato t'i nënshtrohen një gare të hapur dhe siguron rimbursim të arsyeshëm për inovatorin fillestar, pa krijuar avantazh të padrejtë konkurrues.

Në thelb, Kreu III harmonizon rregullat e transparencës, afatet, kriteret dhe mjetet operationale që sigurojnë një proces të hapur, të barabartë dhe të kontrollueshëm për përzgjedhjen e partnerit privat në kontratat e koncesionit/PPP.

Kreu IV – “Llojet e procedurave për dhënien e koncesioneve” i projekt-ligjit përcakton llojet e procedurave të dhënies së kontratave të koncesionit/PPP. Qëllimi i këtij kreu është të sigurojë zbatimin e parimeve të transparencës, konkurrencës së ndershme dhe efikasitetit në prokurimin publik, duke garantuar një kuadër të qartë ligjor dhe institucional.

Neni 49 rendit katër procedurat konkurruese që mund të përdoren nga autoritetet/entet kontraktuese: 1) Procedura e hapur; 2) Procedura e kufizuar; 3) Procedura konkurruese me negociim (vetëm në sektorin klasik); 4) Procedura me negociim me shpallje paraprake të njoftimit (vetëm për kontratat sektoriale). Këshilli i Ministrave ngarkohet të nxjerrë rregulla më të hollësishme për këto procedura.

Neni 50 bën një përshkrim të procedrës së hapur, karakteristikë kryesore e të cilës është pjesëmarrja e lirë e çdo operatori ekonomik të interesuar. Ka vetëm një fazë, ku dorëzohen ofertat, dhe parashikohen afate minimale për dorëzim. Afatet mund të zgjaten nëse dokumentacioni nuk gjendet elektronikisht.

Neni 51 përshkruan procedurën e kufizuar e cila përbëhet nga dy faza: faza e parakualifikimit dhe faza e ofertimit. Vetëm kandidatët që kualifikohen në fazën e parë ftohen për të dorëzuar ofertat.

Kjo procedurë përdoret për të siguruar që vetëm operatorët ekonomikë me kapacitete të provuara të marrin pjesë.

Neni 52 përshkruan procedura konkurruese me negocim, e cila zbatohet vetëm në sektorin klasik dhe është më fleksibël. Ajo përshin disa faza, duke filluar me ftesën për shprehje interesi, parakualifikimin, dorëzimin e ofertave fillestare dhe zhvillimin e negociatave me ofertuesit. Lejon përshtatje të zgjidhjeve dhe mirëpërcaktim të objektit të kontratës.

Neni 53 vijon me përshkrimin e rasteve kur lejohet përdorimi i procedurës konkurruese me negocim, si p.sh. kur projektet janë komplekse, kur objektet nuk mund të përcaktohen qartë që në fillim, apo kur nevojitet mirëpërshtatje me teknologji inovative.

Neni 54 detajon procedurën me negocim me shpallje paraprake të njoftimit, e cila përdoret vetëm për kontratat sektoriale. Pas publikimit të njoftimit, çdo operator ekonomik mund të aplikojë dhe të ftohet për negociim. Kjo procedurë kombinon karakteristikat e transparencës dhe fleksibilitetit.

Dispozitat e Kreut IV janë harmonizim me direktivën e prokurimit publik të BE e cila parashikon të njëjtat procedura. Këto procedura ofrojnë mundësi për zgjedhjen e formës më të përshtatshme të procedurës, varësisht nga specifikat e projektit dhe niveli i kompleksitetit. Përveç rritjes së efikasitetit, kjo ndihmon edhe në ruajtjen e integritetit të procesit konkurrues.

Kreu V “Kontrata e koncesionit/PPP” përshkruan gjithë ciklin jetësor të kontratës PPP - nga nënshkrimi e deri te ndryshimet, garancitë dhe monitorimi - duke vendosur standarde të detajuara për të mbrojtur interesin publik, garantuar sigurinë juridike dhe menaxhuar rreziqet fiskale.

Sipas Nenit 55 – Lidhja e Kontratës - Pas përfundimit të periudhës “stand-still” për ankesa, autoriteti fton ofertuesin fitues në negociata formale; projekt-kontrata i dërgohet për vlerësim përfundimtar Ministrisë përgjegjëse për financat përpara nënshkrimit. Nëse dokumentet e tenderit kërkojnë krijimin e një shoqërie të veçantë (SPV), kontrata nënshkruhet me subjektin e ri pas regjistrimit të tij në Shqipëri.

Përmbajtja e kontratës (Neni 56) kodifikon të drejtat/detyrimet e palëve sipas ligjit dhe dokumenteve të tenderit; çështjet e pambuluara zbatohen nga Kodi Civil. Ajo mund të shoqërohet me marrëveshje plotësuese (p.sh. financimi), të cilat kërkojnë aprovimin paraprak të ministrisë përgjegjëse për financat.

Neni 57 parashikon se para nënshkrimit, koncesionari duhet të depozitojë garanci (bankare, korporate, kambiale etj.) deri në 5 % të vlerës; ajo mund të reduktohet proporcionalisht, por jo më pak se 25 % e shumës fillestare gjatë jetës së kontratës. Autoriteti kontrollon vlefshmërinë e garancive gjatë gjithë periudhës.

Sipas Nenit 58, kur parashikohet në studimin e fizibilitetit, koncesionari paguan një tarifë që kalon në buxhetin e shtetit ose të pushtetit vendor; parametri llogaritet në raport me vlerën, risqet,

kohëzgjatjen dhe fitimin e pritshëm. Urdhëri i ministrit përgjegjës për financat, në rast mos-pagimi, është titull titull ekzekutiv.

Afati i kontratës mund të variojë nga 5 – 35 vjet (Neni 59) dhe përcaktohet në studimin e fizibilitetit, duke siguruar që partneri privat të rikuperojë investimin me një fitim të arsyeshëm, pa kufizuar konkurrencën. Afati mund të zgjatet vetëm nëse është i lidhur me një ndryshim të kontratës të lejuar nga ligji.

Sipas Nenit 60 – Ndryshimi i Kontratës - modifikimet lejohen përsa kohë janë parashikuar qartë në dokumentet origjinale ose kur lindin nevoja objektive (forcë madhore, rreziqe mjedisore, punë/shërbime shtesë të domosdoshme, rrethana të paparashikueshme). Totali i ndryshimit nuk duhet të kalojë 50 % të vlerës së kontratës origjinale dhe nuk mund të ndryshojë natyrën e projektit; çdo modifikim kërkon miratimin paraprak të Ministrisë përgjegjëse për financat dhe shpallet publikisht.

Kontrata mund të transferohet te një palë e tretë që plotëson kriteret e kualifikimit, vetëm me pëlqimin me shkrim të autoritetit kontraktor dhe miratimin e ministrisë përgjegjëse për financat; për marrëveshjet me mbështetje fiskale kërkohet edhe vendim i Këshillit të Ministrave (Neni 61).

Neni 62 parashikon se nënkontraktimi lejohet deri në 50% të vlerës; autoriteti miraton nënkontraktorët dhe mund të paguajë drejtpërsëdrejti nënkontraktorët, me dijeninë dhe miratimin e kontraktorit kryesor, pa çliruar këtë të fundit nga përgjegjësia kryesore.

Pas nënshkrimit, palët hartojnë planin e zbatimit të kontratës dhe e dorëzojnë në APP brenda 5 ditësh. Autoriteti kontraktor raporton periodikisht ecurinë dhe problematikat te APP dhe Ministria përgjegjëse për financat; në fund të kontratës, Njësia e Zbatimit të Kontratës (NJZK) përgatit raportin përfundimtar të realizimit.

Ligji parashikon rastet kur kontrata shpallet absolutisht e pavlefshme (p.sh. nënshkrim pa njoftim paraprak ose në shkelje të procedurës së ankimit) dhe autorizon KPP-në të aplikojë gjoba ose shkurtim afati për të minimizuar dëmin publik.

Neni 65 parashikon ngritjen dhe funksionimin e Njesisë së Zbatimit të Kontratës (NJZK) si një njësi e përhershme brenda autoritetit kontraktues, e ngarkuar me administrimin dhe mbikëqyrjen e kontratave të koncesionit/partneritetit publik privat. Krijimi i kësaj njësie synon të forcojë kapacitetet institucionale për zbatimin korrekt dhe transparent të kontratave, si dhe të garantojë që detyrimet e të gjitha palëve kontraktuese të përmbushen në përputhje me termat dhe afatet e kontraktuara. Neni përcakton qartë detyrat dhe përgjegjësitë e NJZK-së, duke përfshirë monitorimin e performancës, menaxhimin e rreziqeve, raportimin periodik dhe vlerësimin përfundimtar të kontratës. Gjithashtu, është parashikuar mundësia e angazhimit të ekspertizës së specializuar për çështje që kërkojnë njohuri të avancuara teknike ose financiare. Zbatimi i këtij neni kontribuon në rritjen e llogaridhënies, transparencës dhe eficiencës në menaxhimin e kontratave të partneritetit publik privat.

Në tërësi, Kreu V vendos një kornizë të hollësishme për strukturën juridike, financiare dhe operative të kontratave PPP, duke siguruar që çdo ndryshim, garanci, transferim apo raportim të bëhet nën kontroll fiskal e institucional rigoroz, në përputhje me standardet e BE-së dhe praktikat e mira të menaxhimit të risqeve.

Kreu VI i projektligjit, i titulluar “**Çështjet financiare dhe çështjet e lidhura**”, përfshin dispozita të rëndësishme që rregullojnë aspekte të natyrës financiare, të drejtave të pronësisë dhe strukturës ligjore të partneritetit publik privat. Ky kre synon të ofrojë siguri juridike dhe qartësi për të gjitha palët e përfshira në lidhje me menaxhimin e pasurisë, të drejtave pronësore, dhe të detyrimeve financiare gjatë dhe pas periudhës së zbatimit të kontratës. Në mënyrë të veçantë, sanksionohet që objektet e ndërtuara në kuadër të një PPP-je janë pronë e autoritetit kontraktues, përveçse kur parashikohet ndryshe në kontratë, duke garantuar kthimin e aseteve publike në përfundim të kontratës. Dispozitat e këtij kreu gjithashtu rregullojnë krijimin e subjekteve të veçanta për realizimin e kontratës (SPV), si mekanizëm për të rritur llogaridhënien dhe ndarjen e qartë të përgjegjësisë mes palëve. Parashikimet mbi interesat e sigurisë dhe mundësinë për të ofruar garanci ndaj institucioneve financiare synojnë të lehtësojnë financimin e projekteve nëpërmjet mekanizmave të njohur nga praktika ndërkombëtare, duke ruajtur në të njëjtën kohë interesin publik. Dispozita e stabilizimit në fund të kreut përfaqëson një instrument mbrojtës për investitorët privatë në rast të ndryshimeve të legjislacionit pas nënshkrimit të kontratës, e cila mund të aktivizohet vetëm me miratim të Këshillit të Ministrave. Kjo dispozitë ruan balancën ndërmjet tërheqjes së investimeve dhe mbrojtjes së interesit shtetëror dhe publik.

Neni 66 – Marrëdhëniet e pronësisë, përcakton detyrimin për të zgjidhur paraprakisht çështjet pronësore që lidhen me pasuritë e përfshira në një kontratë koncesioni/PPP, qofshin ato pronë publike apo private. Qëllimi është të sigurohet që realizimi i projektit të mos pengohet gjatë zbatimit për shkak të paqartësive apo mosmarrëveshjeve pronësore. Autoriteti kontraktues duhet të sigurojë respektimin e legjislacionit në fuqi dhe të zgjidhë marrëdhëniet e pronësisë në kohë dhe në mënyrë të plotë.

Neni 67 – E drejta e pronësisë, trajton çështjen e pronësisë mbi objektet e ndërtuara gjatë zbatimit të kontratës. Parimi i përgjithshëm është që objektet kalojnë në pronësi të autoritetit kontraktues, përveçse kur përcaktohet ndryshe. Ky nen përcakton gjithashtu që këto kushte pronësie duhet të pasqyrohen qartë në dokumentacionin e tenderit dhe në studimin e fizibilitetit. Po ashtu, përfundimi i kontratës shoqërohet me detyrimin e koncesionarit për të dorëzuar objektet e ndërtuara, duke përforcuar kontrollin publik mbi asetet.

Neni 68 – Subjekti për qëllime të veçanta (SPV) u jep autoriteteve kontraktuese të drejtën të kërkojnë që ofertuesi i suksesshëm të krijojë një subjekt juridik të veçantë (SPV) me seli në Shqipëri, i cili do të lidhë dhe zbatojë kontratën. Përdorimi i SPV-ve synon të sigurojë ndarjen e qartë të përgjegjësisë financiare dhe juridike, duke përmirësuar menaxhimin e riskut dhe garantimin e zbatueshmërisë së kontratës. Ky nen përfshin edhe elementët që duhet të përfshihen në dokumentacionin e tenderit për themelimin dhe funksionimin e këtij subjekti.

Neni 69 – Interesat e sigurisë rregullon mundësinë që koncesionari/partneri privat të sigurojë të drejtat e tij financiare përmes instrumenteve të garancisë ndaj institucioneve financiare, me qëllim mbështetjen e projektit. Kjo mundësohet vetëm me pëlqimin e autoritetit kontraktues dhe lidhet ngushtësisht me kontratat e kredisë për zbatimin e projektit. Dispozita ruan balancën mes nevojës për të lehtësuar financimin dhe nevojës për të mbrojtur interesin publik, duke kufizuar pretendimet e institucioneve financiare vetëm te financimi i kontratës përkatëse.

Neni 70 – Dispozita e stabilizimit, parashikon mundësinë e përfshirjes së një angazhimi detyrues nga autoriteti kontraktues, në emër të shtetit, për të mbrojtur koncesionarin/partnerin privat nga pasojat financiare që rrjedhin nga ndryshimet në legjislacion pas nënshkrimit të kontratës. Ky mekanizëm stabilizimi është një praktikë e njohur në kontratat afatgjata të PPP-ve dhe kërkon miratim me vendim të Këshillit të Ministrave. Qëllimi i tij është të rrisë sigurinë ligjore për investitorët privatë, duke shmangur ndikimet e paparashikueshme të legjislacionit të mëvonshëm në financat e projektit.

Kreu VII, “Ankimi administrativ”, ka për qëllim të sigurojë një mekanizëm të drejtë dhe të hapur për operatorët ekonomikë që ndihen të dëmtuar ose rrezikohen të dëmtohen nga vendimet e autoriteteve kontraktuese gjatë procedurave të koncesionit/PPP. Pjesa kryesore e këtij kreu është e dedikuar për rregullimin e të drejtave dhe procedurave të ankimit administrativ.

Neni 71- E drejta e ankimit, rregullon të drejtën e çdo operatori ekonomik që ka interes në një procedurë konkurruese dhe që ka pësuar ose mund të pësojë dëme nga një vendimarrje e autoritetit kontraktues që pretendohet të jetë në kundërshtim me ligjin. Ky nen gjithashtu i jep mundësinë operatorëve ekonomikë të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe pastaj në gjykatën përkatëse, duke theksuar se ankimi nuk ndalon vazhdimin e procedurës së koncesionit.

Neni 72 - Afatet e ankimit, përcakton afatet e ankimit për operatorët ekonomikë:

10 ditë për ankesa lidhur me dokumentet e procedurës dhe ndryshimet në to.

10 ditë për ankesa pas njoftimit të fituesit ose anulimit të procedurës.

Në rastet e procedurave me faza, afatet janë gjithashtu të përcaktuara për ankesa të ndara pas fazave të parakualifikimit dhe vlerësimit të ofertave.

Afatet e qarta janë të rëndësishme për të garantuar që procedurat e ankimit të jenë të shpejta dhe të efikase.

Neni 73 - Paraqitja e ankesës, përcakton se si duhet të paraqitet ankesa nga operatori ekonomik:

Ankesa duhet dërguar njëkohësisht pranë autoritetit kontraktues dhe Komisionit të Prokurimit Publik. Ajo duhet të përmbajë informacion të detajuar për shkeljet e pretenduara dhe të

bashkëngjitet me dokumentacionin mbështetës. Nëse ankesa nuk është e plotë, Komisioni i Prokurimit Publik do të njoftojë ankimuesin për plotësimin e mangësive.

Ky nen siguron që procesi i ankimimit të jetë i organizuar dhe i qartë, duke i dhënë mundësinë ankimuesve të rregullojnë çdo mangësi.

Neni 74 - Veprimet paraprake, rregullon pezullimin e procedurës konkurruese pas regjistrimit të ankesës në sistemet elektronike. Kjo do të ndodhë automatikisht, duke siguruar që procedura e prokurimit të pezullohet derisa të shqyrtohet ankesa. Gjithashtu, ky nen kërkon që të dhënat për ankesën të bëhen të aksesueshme dhe të shpallen publikisht për operatorët ekonomikë të interesuar. Pezullimi automatik dhe transparencja e procesit ndihmojnë në sigurimin e një procesi të drejtë dhe hapësirës për shqyrtim të plotë të ankesës.

Neni 75 - Të drejtat e operatorëve ekonomikë të interesuar, u jep të drejtën operatorëve ekonomikë të interesuar për të paraqitur argumentet e tyre lidhur me ankesat që mund të ndikojnë në to, duke garantuar mundësinë e përfaqësimit të interesave të tyre në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Neni 76 - Vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik, përcakton kohën dhe mundësitë për Komisionin e Prokurimit Publik për të reaguar ndaj ankesave. Komisioni duhet të japë një përgjigje brenda 10 ditëve dhe ka mundësinë të ndërmarrë vendime të përkohshme për të lejuar vazhdimin e procedurës nëse pezullimi i saj do të dëmtonte interesin publik ose palët e tjera.

Ky nen garanton që Komisioni të reagojë në kohë dhe të mbajë balancën mes interesave të ankimuesve dhe interesave të tjera të procesit.

Neni 77 - Tërheqja e ankimit, rregullon mundësinë për tërheqjen e ankesës nga ana e ankimuesit. Ky veprim ka pasojë ndërprerjen e shqyrtimit të ankesës, duke siguruar që procesi të ndalojë menjëherë kur ankesa tërhiqet.

Neni 78 - Pavlefshmëria e kontratave, parashikon situatat kur një kontratë mund të shpallet e pavlefshme, si për shembull kur nuk janë respektuar procedurat e ankimit ose kur ka ndodhur një konflikt interesi. Ai gjithashtu jep mundësinë që Komisioni i Prokurimit Publik të ndjekë masa të tjera administrative, përfshirë gjobat për shkelje të ligjit.

Neni 79 - Detyrimi për bashkëpunim, kërkon që të gjithë personat përgjegjës në procedurat e prokurimit të bashkëpunojnë plotësisht me hetimet dhe të ofrojnë dokumentacionin e kërkuar. Mungesa e bashkëpunimit mund të çojë në masa disiplinore.

Neni 80 - Kundërvajtjet administrative, përcakton që shkeljet e ligjit, që nuk përbëjnë vepra penale, të dënohen me gjobë, duke siguruar një mekanizëm për ndëshkimin e shkelësve.

Neni 81 - Zgjidhja e mosmarrëveshjeve, rregullon mënyrën se si duhet të zgjidhen mosmarrëveshjet që lindin gjatë proceseve të prokurimit publik, duke përfshirë mundësinë e arbitrazhit ndërkombëtar dhe respektimin e ligjit shqiptar.

Në tërësi, kreu VII synon të sigurojë një proces të drejtë dhe të qartë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe ankimeve në procedurën e koncesionit/PPP, duke ofruar një mekanizëm të detajuar për mbrojtjen e interesave të operatorëve ekonomikë dhe transparencën e procedurave të konkurrimit.

Kreu VIII “Dispozita kalimtare dhe të fundit”, i projektligjit përmban dispozita që lidhen me zbatimin kalimtar të ligjit dhe përmbylljen e rregullimeve ligjore të mëparshme. Dispozitat kalimtare synojnë të sigurojnë një kalim pa probleme nga legjislacioni i vjetër në legjislacionin e ri, duke marrë parasysh procedurat që janë në proces dhe detyrimet për zbatimin e akteve nënligjore.

Neni 82 – Shfuqizimet, përcakton shfuqizimin e Ligjit nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik-privat” të ndryshuar, që ka qenë në fuqi më parë. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji të ri, ligji i mëparshëm për koncesionet dhe partneritetet publiko-private nuk do të jetë më i vlefshëm dhe të gjitha dispozitat që rregullojnë këtë fushë do të zëvendësohen nga rregullat e përcaktuara në projektligjin aktual.

Neni 83 - Zbatimi i dispozitave, përcakton se dispozitat e këtij ligji nuk do të zbatohen për veprimet dhe procedurat që kanë nisur për dhënien e koncesioneve dhe partneriteteve publike-private para hyrjes në fuqi të këtij ligji. Kjo është një dispozitë kalimtare që siguron se procedurat e hapura dhe veprimet e ndërmarra nën rregullat e ligjit të mëparshëm do të vazhdojnë të zbatohen deri në përfundim të tyre, duke shmangur çdo konfuzion në lidhje me statusin e kontratave të nisura më parë.

Neni 84 - Aktet nënligjore, përcakton detyrimin për miratimin e akteve nënligjore që janë të nevojshme për zbatimin e dispozitave të ligjit brenda një periudhe prej tre muajsh nga hyrja në fuqi e tij. Këto akte përfshijnë udhëzime dhe rregullore që mbulojnë aspekte të ndryshme të ligjit, siç janë procedurat e garës, vlerësimi i ofertave, si dhe rregullat për administrimin e kontratave të koncesioneve/partneriteteve publike-private.

Ministri përgjegjës për financat gjithashtu ka detyrimin të miratojë një udhëzim brenda të njëjtit afat, që do të sqarojë procedurat e specifikuar në ligj dhe që do të ndihmojë në zbatimin e duhur të tij.

Neni 85 - Kontratat e koncesionit të nënshkruara, thekson se ligji i ri nuk zbatohet për kontratat e koncesionit që janë nënshkruar para hyrjes në fuqi të tij, përveç dispozitave që rregullojnë regjistrin e koncesioneve dhe partneriteteve publike-private. Këto kontrata do të vazhdojnë të zbatohen sipas kushteve të ligjit të mëparshëm, por kërkohet që për këto kontrata regjistri të përditësohet brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e ligjit të ri.

Kreu në fjalë përmban dispozita kalimtare dhe të fundit që rregullojnë kalimin nga ligji i vjetër në ligjin e ri për koncesionet dhe partneritetet publike-private, duke siguruar që procedurat e nisura tashmë të vijojnë si dhe që aktet nënligjore të miratohen në mënyrë efikase dhe të drejtë.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT.

Ngarkohen me zbatimin e këtij akti Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Ministria e Financave, Agjencia e Prokurimit Publik dhe Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTVENDIMIT

Projektvendimi është hartuar nga Grupi Ndërinstitucional i punës (i ngritur me urdhrin nr. 57, datë 18.4.2024 të Kryeministrit) në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.

Drafti është publikuar në Regjistrin e Njoftimit dhe Konsultimit Publik në datën 9.5.2025 dhe konsultimi mbyllet në datë 6.6.2025.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektligji shoqërohet me efekte financiare të cilat do të mbulohen nga buxheti i shtetit.

X. HYRJA NË FUQI E PROJEKTAKTIT.

Ky projektligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI

Blendi GONXHJA